

Kthim përgjigjeje: Instrumenti i zhvillimit të viteve të ciklit të lartë fillor (Middle Year Development Instrument - MDI)

Të dashura familje

Ne në Bordin Shkollor të Qarkut Hamilton-Wentworth (HWDSB) jemi të angazhuar për identifikimin dhe heqjen e pengesave, që të gjithë nxënësit të mësojnë në ambiente mbështetëse, përfshirëse dhe të respektueshme. Ne gjithashtu mbështesim mirëqenien e nxënësve me programe, mbështetje dhe shërbime që nxisin zhvillimin e shëndetshëm dhe shërimin nga pandemia e COVID-19.

Në nëntor, nxënësit e klasave të 4-ta deri në të 12-ta do të përfundojnë Instrumentin e Zhvillimit të Viteve të Ciklit të Lartë Fillor (MDI). Nxënësit nga klasat e 4-ta deri në të 8-ta e përfunduan këtë sondazh në vitin 2018 dhe disa studentë si nga cikli i ulët (fillore) ashtu dhe i lartë (pasfillore) përfunduan një version të shkurtuar të MDI pranverën e kaluar. Në nëntor, studentët do ta kryejnë këtë sondazh (anketim) në internet gjatë orarit të shkollës me mbikëqyrjen e personelit shkollor. Përgjigjet e fëmijës suaj do të jetë private, konfidenciale dhe nuk do të identifikohen me emër.

Cili është qëllimi i studimit?

HWDSB dëshiron të kuptojë më mirë aspektet e zhvillimit të fëmijës në vitet e ciklit të lartë të arsimit bazë të cilat ndikojnë në mirëqenien, shëndetin dhe suksesin shkollor. Sondazhi do të kërkojë nga nxënësit të shprehin mendimet e tyre, ndjenjat dhe përvojat në shkollë dhe në komunitet. HWDSB do të përdorë rezultatet e studimit për të marrë vendime të rëndësishme për programe dhe shërbime të afta të bëjnë një ndryshim për fëmijët.

Sondazhi u bën nxënësve pyetje në lidhje me:

- 1) Zhvillimin emocional dhe social, të tilla si vetë-vlerësimi, optimizmi, lumturia dhe ndjeshmëria;
- 2) Ndjenjën e lidhjes me shkollën, familjen, miqtë, dhe komunitetet;
- 3) Përvojat shkollore;
- 4) Shëndetin fizik dhe mirëqenien; dhe
- 5) Përdorimin e kohës pas orëve të mësimi, si dhe dëshirat e fëmijëve për orët pas-shkollore.

Si mbrohet privatësia e fëmijës tim?

Fëmija juaj nuk do të identifikohen me emër në këtë studim. Përgjigjet e fëmijës suaj nuk do të jenë të disponueshme për ju ose për ndonjë shkollë tjetër ose për personelin e bordit të shkollës. Kjo është për të bërë të mundur që përgjigjet e secilit fëmijë të jenë private dhe

konfidenciale. Asnjë informacion nuk është shtuar në të dhënat shkollore të fëmijës suaj nga studimi.

Në qoftë se informacioni i MDI përdoret në botime kërkimore apo në dokumente publike, fëmija juaj dhe shkolla e fëmijës suaj nuk do të identifikohen në asnjë mënyrë. Në qoftë se vjen një moment që fëmija juaj nuk dëshiron më të marrë pjesë në sondazh, mësuesi përkatës do të ofrojë një aktivitet alternativ shkollor.

Të dhënat personale mbi MDI janë mbledhur në përputhje me nenin 28 (2) të Ligjit mbi Lirinë Bashkiake të Informimit dhe Mbrojtjen e Ligjit të Privatësisë (MFIPPA) i cili nënvizon se organizatat e angazhuara në veprimtaritë e autorizuara ligjërisht mund të mbledhin informacion personal nga individët në rastet kur është e nevojshme. MDI ndihmon për përmbushjen e kërkesave të Ministrisë së Arsimit që bordet shkollore të kryejnë sondazhe me nxënësit çdo 2 vjet në lidhje me atmosferën në shkollën e tyre.

Si do të përfitojnë shkolla dhe komuniteti?

Studimi i MDI ndihmon edukatorët, planifikuesit e programeve dhe anëtarët e komunitetit të mësojnë në lidhje me jetën e fëmijëve përmes zërave të vetë fëmijëve. Shkolla dhe komuniteti juaj mund të përdorin rezultatet për të përmirësuar jetën e fëmijëve. Ne besojmë se studimi ofron shumë përfitime pozitive për fëmijët e zonës dhe familjet e tyre. HWDSB do të punojë me partnerët duke përfshirë edhe Bashkinë e Hamilton-it për të garantuar përmbushjen nga ana jonë të nevojave të nxënësve në komunitetin tonë. Ne do të ndajmë të dhëna të de-identifikuara nga sondazhi me Bashkinë e Hamilton-it për të informuar dhe për të pasuruar programet dhe shërbimet e veta për fëmijët dhe të rinjtë.

Ku mund të merret më shumë informacion?

Ju lutem mësoni më tepër për MDI, që është përdorur në juridiksione të tjera kanadeze, në internet në www.earlylearning.ubc.ca/mdj.

Ju gjithashtu mund të merrni informacion dhe burime rreth sondazhit të Zhvillimit të Viteve të Ciklit të Lartë Fillor në faqen tonë të internetit në

<https://www.hwdsb.on.ca/elementary/supports/mental-health-and-well-being/mdj/>

Nëse keni ndonjë pyetje apo shqetësime në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijës suaj, ju lutem kontaktoni Departamentin e Kërkimeve dhe Analizimit në research@hwdsb.on.ca 905-527-5092.

HWDSB

Research and Analytics Department
Hamilton-Wentworth District School Board
20 Education Court, P.O. Box 2558
Hamilton, ON L8N 3L1

Me respekt

Bordi Shkollor i Qarkut Hamilton-Wentworth
Departamenti i Kërkimeve dhe Analizimit

curiosity • creativity • possibility